



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1754/2 Prot.

Tiranë, më 20.12.2024

VENDIM

Nr. 25, Datë 20.12.2024

PËR

ZGJEDHJEN E ANËTARËVE STUDENTË TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM
TË MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME
STUDENTËT, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1(i), në nenin 46, pikat 1, 2, 3 dhe 6 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 30, pikat 3, germa “c” dhe “d” dhe nenin 34 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 21, pikat 2, gjerat “c” dhe “d” dhe neni 26 të Rregullores së Universitetit të Arteve, në nenin 4, pika 1, germa “s” të Rregullores së Funksionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, si dhe VSA Nr. 23, datë 12.12.2024 “Për caktimin e periudhës së vetëkandidimit për anëtarë në komisionin e mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, në Universitetin e Arteve”, në Procesverbalin e mbajtur nga Sekretariati Teknik i SA, me nr. 1754/1 prot, datë 19.12.2024 ku jepet informacioni mbi personat e vetëkandiduar, pas numërimit të të gjitha fletëve të votimit, të ndara nga Sekretariati Teknik, PRO/KUNDËR/ABSTENIM, në mënyrë unanime,

VENDOSI:

1. Të zgjedhë anëtarët, përfaqësues të studentëve, në Komisionin e Përherëshëm të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, në Universitetin e Arteve, sipas rezulttit të votimeve të anëtarëve të Senatit Akademik, si më poshtë:

- SIBORA AGASI Fakulteti i Muzikës
- HENRI ALLA Fakulteti i Arteve të Bukura
- EDISON LLESHI Fakulteti i Artit Skenik

2. Vendimi i kalon për dajeni Bordit të Administrimit në lidhje me efektin financiar.

3. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA

Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Kristina LAÇO

Prof. Asoc. Genci FUGA


Prof. Asoc. Alert ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK
SEKRETARIATI

Nr. 1754/1 Prot.

Tiranë, më 19.12.2024

PROCESVERBAL

Në përfundim të afatit të vetëkandidimit për anëtar të Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, në Universitetin e Arteve, sipas Vendimit të Senatit Akademik nr. 23, datë 12.12.2024 “Për caktimin e periudhës së vetëkandidimit për anëtarë në Komisionin e Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, në Universitetin e Arteve” (bashkëngjitur), Ju bëjmë me dije se pranë Sekretariatit të Senatit Akademik, nga data 13.12.2024 e deri më datë 18.12.2024, janë vetëkandiduar 5 (pesë) student nga 3 (tri) fakultetet e UART, si më poshtë vijon:

A. Fakulteti i Muzikës

1. Sibora Hajrulla Agasi

B. Fakulteti i Arteve të Bukura

1. Sindi Hysni Islamukaj
2. Henri Xhelil Alla

C. Fakulteti i Artit Skenik

1. Edison Kolë Lleshi
2. Livion Remzi Aliaj

Dokumentacioni i dorëzuar prej secilit kandidat është:

1. Formulari i aplikimit;
2. Fotokopja e dokumentit të identifikimit;
3. Lista e notave;
4. Vërtetimi i studentit.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARIATI TEKNIK I SENATIT AKADEMIK

Adela Kusuri

Manjola Thaçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1754 Prot.

Tiranë, më 12.12.2024

VENDIM

Nr. 27, Datë 12.12.2024

PËR

**CAKTIMIN E PERIUDHËS SË VETËKANDIDIMIT PËR ANËTARË NË
KOMISIONIN E MBARËVAJTJES SË VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE
ME STUDENTËT, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, pika 1(i), në nenin 46, pikat 1, 2, 3 dhe 6 të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 30, pikat 3 (c)/(d) dhe nenin 34 të Statutit të Universitetit të Arteve, në nenin 21, pikat 2 (c) dhe (d) dhe nenin 26 të Rregullores së Universitetit të Arteve, në nenin 4, pika 1(s) të Rregullores së Funkcionimit të Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, me votim të hapur,

VENDOSI:


1. Fillimin e procedurës për marrjen e kandidaturave për 3 (tre) anëtarë, përfaqësues të studentëve, 1 (një) për secilën njësi kryesore/fakultet, në Komisionin e e Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin e Arteve.
2. 3 (tre) anëtarët e Komisionit, nga 7 (shtatë) anëtarë gjithsej, vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Aplikimet duhet të paraqiten pranë Sekretariatit Teknik të Senatit Akademik, nga data 13.12.2024 deri më datë 18.12.2024, nga ora 08:00, deri më 16:00.
4. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparencë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Najada HAMZA



Prof. Arben LLOZI

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Lorenc RADOVANI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Endri SINA

Prof. Rudina CIKO

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI

Prof. Asoc. Kristina LAÇO

Prof. Asoc. Genci FUGA

Prof. Asoc. Aleri ÇELOALIAJ

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea TRIMI (Student FAB)

Rei KITA (Student FM)

